



Roli i Fesë në Shoqëritë e Ballkanit Perëndimor

PËRMBLEDHJE E PUNIMEVE
TË KONFERENCËS
11-12 QERSHOR 2019



Kingdom of the Netherlands



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Sqarim: Kjo konferencë është organizuar në kuadër të Projektit ‘Shqyrtimi i rolit të Fesë në Shoqëritë e Ballkanit Perëndimor’ me mbështetjen e një granti të mundësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Holandës si pjesë e Fondit për të Drejtat e Njeriut. Objektivat, zbatimi dhe përfundimet e projektit janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë projekt janë të organizatës zbatuese dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Holandeze.

Partnerët zbatues:



INSTITUTE OF SOCIAL SCIENCES
AND HUMANITIES
SKOPJE



BOS
BELGRADE
OPEN
SCHOOL



ANALITIKA
Center for Social Research

Autore

Lejla Hodžić

Të gjitha të drejtat e rezervuara. ©IDM 2019.

Faqosja dhe dizajni: Eduart Cani

Përkthimi: Alfonc Rakaj

Përmbajtja

Prezantimi i Konferencës	4
Ceremonia hapëse	5
Sesioni 1: Feja, komuniteti dhe qytetarët	7
Sesioni 2: Feja dhe demokracia	11
Sesioni 3: Feja, shteti dhe siguria	15
Sesioni 4: Islami dhe laiciteti në Ballkanin Perëndimor	18
Përfundimet	21

Prezantimi i konferencës

Konferenca ‘Roli i Fesë në Shoqëritë e Ballkanit Perëndimor’ është një konferencë rajonale e organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Shqipëri në bashkëpunim me Qendrën për Kërkime Shoqërore Analitika në Bosnjë dhe Hercegovinë, Shkolla e Hapur e Beogradit në Serbi, dhe Instituti i Shkencave Sociale dhe Humane - Shkup (ISSHS) në Maqedoninë e Veriut. Synimi i konferencës ishte të shqyrtonte kërcënimet dhe mundësitë ekzistuese të lidhura me rolin e fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor si dhe të ndihmonte në përmirësimin e mekanizmave shoqërore dhe politike për t’iu përgjigjur në mënyrë më efektive sfidave që rrjedhin prej saj. Një vëmendje parësore gjatë konferencës morën artikujt akademikë të përgatitura enkas për këtë rast. Bashkë me artikujt akademikë, pjesëmarrësit u njohën edhe me rezultatet e anketimit të elitës mbi rolin e fesë në shoqëritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përtej faktit që konferenca bëri bashkë përfaqësues të komuniteteve fetare, akademikë, zyrtarë publikë, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile nga Ballkani Perëndimor, por nxiti një diskutim më të gjerë ndërmjet tyre mbi mundësitë për forcimin e rolit të fesë në shoqëritë e vendeve të rajonit. Pjesëmarrësit nënvizuan kontributin dhe ndikimin e mundshëm të fesë në përballimin e sfidave si zhvillimi i ulët ekonomik, tranzicioni i ngadaltë dhe sundimi i dobët i ligjit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Konferenca është organizuar me mbështetjen bujare të Ministrisë për Punët e Jashtme të Mbretërisë së Holandës dhe me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesisë së Tij, z. Ilir Meta.

Ceremonia hapëse

Ceremonia hapëse u organizua në Pallatin e Brigadave në Tiranë me pjesëmarrjen e **Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, Z. Ilir Meta**. Aty u mbledhën pjesëmarrësit e konferencës, anëtarë të elitës politike shqiptare dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në Shqipëri. Shkëlqesia e Tij, Presidenti Meta dhe **Shkëlqesia e Saj, Znj. Guusje Korthals Altes, Ambasadore e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri**, përshëndetën pjesëmarrësit dhe të ftuarit, dhe gjatë fjalimeve nënvizuan historinë dhe traditën e bashkëjetesës dhe harmonisë fetare në Shqipëri. Shkëlqesia e Tij, Presidenti Meta theksoi se harmonia fetare është një ndër vlerat e trashëguara historike të Shqipërisë, një vlerë e cila duhet ruajtur dhe kultivuar nga brezat e ardhshëm. Presidenti vuri në pah edhe historinë e mëvonshme të vendit, kohën në të cilën regjimi totalitar e bëri Shqipërinë vend ateist. Presidenti theksoi se e shkuara shërben për të na kujtuar rëndësinë e të drejtave dhe lirive personale dhe të përbashkëta, përfshi edhe lirinë fetare.¹ Shkëlqesia e Saj, Ambasadorja e Holandës në Shqipëri gjithashtu solli në vëmendjen e të pranishmëve rëndësinë e lirisë fetare në shoqëritë demokratike si një e drejtë thelbësore për të gjithë. Në vazhdim, ajo vuri në pah faktin që Ballkani Perëndimor ka një strukturë të larmishme fetare dhe etnike e cila përbën një vlerë e cila duhet përçafuar dhe promovuar, veçanërisht pasi në ditët tona feja luan një rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet e jetës.

Fjalimet hapëse u mbajtën nga anëtarë të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë: Fortlumenturia e tij, Anastas Janullatos, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë; H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mons. George

Frendo, Kreu i Konferencës Ipeshkvnore Katolike të Shqipërisë; H. Dede Edmond Brahimaj, Kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane; dhe Pastor Ylli H. Doçi, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, **Fortlumenturia e Tij, Anastas Janullatos** i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe nënvizoi rolin e rëndësishëm të fesë në formimin e kulturës, ndërgjegjes dhe identitetit kombëtar në Ballkanin Perëndimor. Sipas Kryepeshkopit Anastas, larmishmëria dhe bashkëjetesa e bashkësive fetare është penguar nga aktorët jofetarë (si nacionalizmi apo politika) dhe faktorët fetarë si radikalizmi. Në mbyllje të fjalimit, ai theksoi se është e nevojshme që komunitetet fetare në Ballkanin Perëndimor të njihen me aspektet pozitive të komuniteteve të tjera fetare në rajon, të mësojnë prej tyre dhe të bashkëpunojnë me to.

Zoti H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nënvizoi rolin parësor të luajtur nga udhëheqësit fetarë në formimin e identitetit kombëtar ndërsa mbështetën ngjarje si Lidhjen e Prizrenit, Pavarësinë e Shqipërisë dhe arritje të tjera të rëndësishme. Z. Spahiu theksoi se udhëheqësit fetarë në Shqipëri janë krenarë për këtë trashëgimi dhe ndihen përgjegjës për ta ruajtur dhe promovuar për brezat e ardhshëm. Në vijim ai vuri në pah se që nga krijimi i Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH), institucioni që ai drejton ka promovuar vlera si mikpritjen, bujarinë, moralin dhe bashkëjetesën mes komuniteteve fetare dhe etnike në vend. Sot, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë luan një rol të rëndësishëm në arsimimin e të rinjve në shkollat e financuara



1 Zyra e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, 11 qershor 2019, Presidenti Meta përshëndet Konferencën Rajonale mbi “Rolin e Fesë në Shoqëritë e Ballkanit Perëndimor”, <http://president.al/presidenti-meta-pershendet-konferencen-rajonale-mbi-rolin-e-fese-ne-shoqerite-e-ballkanit-perendimor/>

prej tij. Zoti Spahiu vuri në pah rëndësinë e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë si institucion që mundëson nxitjen e kontributit në shoqëri, ndarjen e shqetësimeve dhe shkëmbimin e ideve mes bashkësive fetare.

Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Mons George A. Frendo në fjalën e tij i uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve të konferencës duke nënvizuar se paqja është karakteristikë e qenësishme e të gjitha besimeve. Megjithatë, sipas tij, paqja nuk është e mirëqenë por arrihet me mund dhe përkushtim të palëkundur. Prandaj, udhëheqësit fetarë duhet të kontrollojnë ekstremizmin dhe elementet e rrezikshëm brenda bashkësive përkatëse, si dhe të promovojnë bashkëjetesën paqësore dhe harmoninë ndërfetare. Arqipeshkvi Frendo theksoi rëndësinë e të drejtave të njeriut, dinjitetit dhe përgjegjësinë e autoriteteve publike për të qenë besnikë të parimit jodiskriminues ndaj bashkësive fetare. Së fundmi, Arqipeshkvi Frendo e vuri theksin tek nevoja për të shprehur solidaritet me bashkësitë e tjera fetare në kohë të vështira.

H. Dede Edmond Brahimaj, Kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane përshëndeti pjesëmarrësit duke theksuar se Ballkani Perëndimor përfaqëson

një mozaik me larmishmëri fetare i cili është rezultat i ngjarjeve historike, shkëmbimeve kulturore dhe traditave të hershme. Ai vuri në pah se gjatë procesit të formimit të shteteve, grupet kulturore shkëmbyen elemente të ndryshme mes tyre, ndërsa bashkësitë fetare luajtën një rol të rëndësishëm në formësimin e identiteteve në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ai njohu të pranishmit me historinë dhe rëndësinë e komunitetit Bektashian në rajon dhe nxiti pjesëmarrësit të mësojnë edhe për bashkësitë e tjera fetare, përveç atyre që përfaqësojnë. Ai e mbylli fjalimin duke iu bërë thirrje udhëheqësve fetarë të bashkohen kundër politizimit të fesë në rajon.

Pastor Ylli H. Doçi, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, ftoi pjesëmarrësit e konferencës të jenë të hapur ndaj një debati me bazë respektin mbi çështjet e diskutueshme në marrëdhëniet shoqërore. Si përfaqësues i komunitetit më të ri, Pastor Doçi theksoi se bashkësitë fetare jetojnë në harmoni dhe kjo frymë bashkëpunimi dëshmohet fuqishëm në bashkëveprimin e tyre kombëtar. Sipas tij, kjo është mundësuar nga vizioni i përbashkët që kanë bashkësitë fetare për një shoqëri demokratike. Si dëshmi e kësaj, ai vuri në pah Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë.

Feja, komuniteti dhe qytetarët

Societati

1

Sesioni 1: Feja, komuniteti dhe qytetarët

Gjatë sesionit të parë u prezantuan folësit, synimet e konferencës dhe u ftuan pjesëmarrësit të bëhen pjesë e diskutimeve lidhur me rolin e fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor dhe disa prej çështjeve më të gjera të lidhura me fenë si toleranca ndërfetare, liria e fesë dhe roli i fesë në përcimin e vlerave në shoqëri. **Z. Sotirag Hroni, Drejtori Ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim** dhe **Milorad Bjeletić, Drejtori Ekzekutiv i Shkollës së Hapur të Beogradit** përshëndetën dhe i uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve. Në vazhdim, z. Gjergji Vurmo, Drejtor Programi pranë IDM-së, sqaroi pjesëmarrësit mbi përmbajtjen e konferencës duke shtuar se sesionet do të paraprihen nga fjalime hapëse dhe do të pasohen nga prezantimi i artikujve akademikë të publikuara në Volumin e Konferencës. Në vazhdim, z. Vurmo moderoi sesionin e parë.

Fjalimi i parë u mbajt nga **Krye Rabini i Komunitetit Hebre të Beogradit, z. Isak Asiel**, i cili foli për fenë në shoqëritë në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Gjatë fjalimit, ai iu referua një shoqërie apo shoqërive që po kalojnë një periudhë tranzicioni si shkretëtira që përmendet në Bibël. Sikurse përshkruhen në Bibël, shkretëtirat u braktisën nga njerëzit të cilët kërkonin Tokën e Premtuar për një kohë të gjatë, ndërsa njerëzit në shoqëritë tranzitore kalojnë një pjesë të mirë të kohës duke u përpjekur të largohen nga vendi i tyre për të shkuar në shoqëri me kushte më të mira jetese. Rabini Asiel vuri në pah sesi udhëheqësit fetarë dhe komuniteti mund të kontribuojnë për shoqërinë duke marrë si shembull Myftiun e Beogradit Muhamed Jusufspahić, që është emëruar Ambasador i Serbisë në Arabinë Saudite, i cili gjatë një programi televiziv, ftoi udhëheqësit fetarë të Serbisë për të diskutuar mbi problemet e ndryshme me të cilat përballet shoqëria serbe. Sipas Rabinit Asiel, udhëheqësit shpalosën një

sërë idesh dhe mënyrash për të zgjidhur çështjet e diskutuara, pavarësisht se ata kishin prejardhje dhe përkatësi fetare të ndryshme. Sipas tij, korrupsioni dhe shpërfytyrimi i drejtësisë janë dy sfida kyçe për shoqërinë në Serbi, dhe sipas Rabinit, udhëheqësit fetarë kanë akoma hapësirë për ta shfrytëzuar të cilën duhet ta përkthejnë në bashkëpunim më të ngushtë me njerëzit e thjeshtë dhe t'iu bëjnë ballë sfidave. Ai shtoi se është me rëndësi të mos harrohet që si rrjedhojë e keqpërdorimit të pushtetit nga disa politikanë të rajonit, shoqëritë e Ballkanit Perëndimor sundohen nga frika, korrupsioni dhe mungesa e sundimit të ligjit. Kjo ka bërë që ato të shpenzojnë shumë kohë në tranzicion, shkak kryesor i të cilit është mungesa e qartësisë mbi mënyrën sesi të shfrytëzonin liritë dhe të drejtat e fituara. Thelbi i mesazhit të Rabinit Asiel për bashkësitë fetare në rajon dhe udhëheqësit e tyre është: 'Ne [udhëheqësit fetarë] duhet të jemi pjesë e kontribuesve dhe jo pjesë e shfrytëzuesve'.

Gjatë fjalimit kryesor të sesionit, Znj. Leonie Vrugtman nga IDM prezantoi gjetjet e anketimit të elitës mbi rolin e feve në Ballkanin Perëndimor, ndërsa z. Ylli H. Doçi, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë nënvizoi rolin dhe funksionet e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Rëndësia e udhëheqësve fetarë dhe fesë në vendet e rajonit doli në pah edhe nga gjetjet e anketimit të cilat u prezantuan nga **Znj. Leonie Vrugtman**. Në këtë anketim morën pjesë përfaqësues të elitës kulturore, politike dhe shoqërore të vendeve përkatëse dhe dëshmoi që pjesa dërrmuese e të anketuarve të rajonit mendojnë se feja luan rol në jetën e përditshme të shoqërisë. Anketimi gjithashtu trajtoi edhe rolin e fesë në çështjet shoqërore, politike dhe opinionin publik. Sipas gjetjeve të anketimit, feja dhe udhëheqësit fetarë nuk

luajnë një rol të rëndësishëm vetëm në çështjet shoqërore, por edhe në çështjet politike (si pjesëmarrja demokratike, sjellja në votime apo qasja ndaj partive politike) dhe opinionin publik - veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në vlerësimin e marrëdhënieve ndërfitare në vendet përkatëse, të anketuarit në Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi, Maqedoninë Veriore dhe Serbi; i cilësuan si 'mesatare': pra as të mira as të këqija. Ndërsa në Kosovë dhe Shqipëri, marrëdhëniet ndërfitare u cilësuan si më të përafërta me harmoninë fetare. Analiza e anketimit të elitës në vendet e rajonit sugjeron se vendet etnikisht më heterogjene si Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ndikimi i fesë në çështjet sociale si bashkëjetesa paqësore, kohezioni shoqëror, marrëdhëniet ndërfitnike dhe demokracia shihen si më negative se në vendet që janë etnikisht homogjene. Shkak për këtë mund të jenë lufta e viteve 1992-1995 në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe konflikti i armatosur në vitin 2001 në Maqedoninë e Veriut të cilat kanë ndikuar në ftohjen e marrëdhënieve ndërfitnike. Megjithatë, elitat e anketuara shprehën se ka mundësi të mëdha, të pashfrytëzuara, nëpërmjet të cilave udhëheqësit fetarë mund të ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërfitare dhe kohezionin shoqëror në rajon. Sipas tyre, klergjia mund të luajë një rol vendimtar në promovimin e vlerave etike dhe universale, si dhe në nxitjen e dialogut ndërfitar, proces në të cilin ata duhet të udhëheqin me forcën e shembullit' dhe 'të jetësojnë praktikën e bashkëpunimit dhe respektit ndërfitar'.

Në fjalën e tij, **z. Ylli H. Doçi, Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë** prezantoi studimin e titulluar 'Këshilli Ndërfetar për Kohezionin Shoqëror në Ballkanin Perëndimor' ku shpalosi sugjerimet e tij për përmirësimin e marrëdhënieve ndërfitare. Sipas tij, institucione të specializuara si Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë nxisin e mundësojnë dialogun mes bashkësive fetare. Duke marrë shkas nga Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, ai theksoi rëndësinë e larmishmërisë fetare në Ballkanin Perëndimor si një karakteristikë e veçantë, e cila në vetvete nuk garanton tolerancë. Ai e mbylli prezantimin duke shtuar që toleranca është një vlerë e cila duhet vlerësuar e kultivuar brez pas brezi.

Gjatë fjalës së tij, z. Doçi, shqyrtoi arsyet e mundshme të cilat kanë çuar në dështimin e institucioneve ndërfitare në rajon. Ai theksoi se mungesa e vullnetit nga ana e bashkësive fetare dominuese mund ta vështirësojë procesin. Në vazhdim, z. Doçi shpjegoi kuptimin e fesë 'dominuese' dhe deri në çfarë pike ndikojnë ato në përkufizimin e institucioneve ndërfitare. Sipas tij, një fe 'dominuese' është ajo fe e cila përfaqëson numrin më të lartë të besimtarëve në një shtet të caktuar. Gjatë sesionit, pjesëmarrësit vunë në pah vështirësinë e përcaktimit të saktë të një feje 'dominuese'. Gjithashtu, ata theksuan se është e vështirë të përcaktohen tiparet që një fe duhet të ketë në një shoqëri për t'u caktuar si e tillë. Disa nga pjesëmarrësit nënvizuan që demografia nuk e bën domosdoshmërisht një fe dominuese. Duke patur parasysh rëndësinë e terminologjisë, pjesëmarrësit diskutuan sfidat e mundshme që paraqet përdorimi i fjalës 'fe dominuese' pasi mund të çojë në keqkuptime, veçanërisht pasi mund të cilësohet si mbizotëruese mbi fetë apo bashkësitë e tjera fetare. Kjo mund të bëhet shqetësuese pikërisht sepse fetë cilësohen të gjitha të barabarta. Për arsyet e sipërpërmendura, pjesëmarrësit ranë dakord që fjala 'më e përhapur' mund të jetë më e përshtatshme sesa 'dominuese' në përdorim, sidomos kur merren parasysh ngjarje historike, zhvillimet e feve apo e ardhmja e tyre në përgjithësi. Gjithsesi, është me rëndësi të trajtohet roli i udhëheqësve të bashkësive fetare të cilat përbëjnë shumicën në shoqëri sepse ato mund të marrin më shumë përgjegjësi për të marrë përsipër nisma për platforma të përbashkëta apo bashkëveprim sesa fetë që mund të cilësohen si minoritare në krahasim.

Përfundimi i nxjerrë nga diskutimi ishte që Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është një shembull i mirë i një institucioni ndërfitar, ndërsa në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, nisma të ngjashme kanë dështuar në përmbushjen e rolit të tyre në rang kombëtar. Bosnja dhe Hercegovina u përmend si një rast i tillë, ku Këshilli Ndërfetar nuk ia doli të vazhdonte më tej dialogun ndërfitar. Si rrjedhojë, gjatë diskutimit lindi pyetja nëse Bosnja dhe Hercegovina mund të nxirrte mësim nga përvoja e Shqipërisë. Folësit theksuan njëzëri rëndësinë e përafrimit të udhëheqësve fetarë, shkëmbimin

e ideve, mendimeve dhe shqetësimeve mes tyre si pjesë e përpjekjeve për të përcaktuar një platformë të përbashkët për udhëheqësit e bashkësive fetare në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Duke marrë parasysh që të anketuarit në Maqedoninë e Veriut kanë perceptimin më negativ ndaj marrëdhënieve ndërfitare në rajon, audienca ngriti pyetje lidhur me shkaqet që nxisin dallimet në perceptim mes vendeve të ndryshme. Një pjesëmarrës argumentoi se kjo mund të jetë pasojë e mundësive të brishta ekonomike apo nivelit të varfërisë, të cilat cilësohen edhe faktorë të rëndësishëm, në bashkëveprim me një sërë elementësh të tjerë, që çojnë njerëzit në rrugën e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, pjesa dërrmuese e folësve hodhi dyshime për ndikimin e drejtpërdrejtë të gjendjes ekonomike mbi marrëdhëniet ndërfitare. Në fjalën përmbyllëse u theksua se udhëheqësit fetarë nuk janë spektatorë, por pjesëmarrës aktiv të shoqërisë të cilët duhet të tregojnë më shumë vullnet për t'u angazhuar. Si përfundim, pjesëmarrësit ranë dakord mbi nevojën për të denoncuar institucionet fetare që abuzojnë me pushtetin e tyre në mënyrë që t'i hapet rrugë edhe zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërfitare.

Sesioni 2: Feja dhe demokracia

Ky sesion shqyrtoi marrëdhënien e fesë dhe shtetit në vendet e rajonit që kanë përjetuar tranzicionin nga regjimi komunist në demokraci. Në këtë sesion, z. Vedat Sahiti, Këshilltar i Kryemyftiut të Kosovës dhe At Photius, Abot i Manastirit të Berovos, pjesë e Kishës Ortodokse në Maqedoninë e Veriut mbajtën edhe fjalimet hapëse. Në vazhdim, z. Marko Veković, Ndihmës Profesor i Fesë dhe Politikës pranë Universitetit të Beogradit, prezantoi studimin e tij ‘Në kërkim të “Tolerancës së ndërsjellë”: Demokracia dhe Marrëdhëniet Shtet-Fe në Serbi dhe Malin e Zi’. Z. Jeton Mehmeti, Drejtor i Kërkimit pranë Institutit GAP në Kosovë foli mbi kuadrin ligjor që sanksionon fetë dhe bashkësitë fetare. Së bashku, folësit pasqyruan në mënyrë të përmbledhur statusin aktual të marrëdhënieve shtet-fe në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Malin e Zi.

Këshilltari i Kryemyftiut të Kosovës, z Vedat Sahiti theksoi gjatë fjalimit të tij larmishmërinë fetare dhe kulturore të rajonit të Ballkanit Perëndimor ku janë kryqëzuar rryma dhe ndikime të ndryshme gjatë shekujve. Sipas tij, besimi fetar ka ndikuar në formimin e identitetit kombëtar, kulturor dhe shoqëror të popujve në rajon. Ai nënvizoi nevojën e promovimit të vlerave të familjes nga ana e udhëheqësve fetarë, pjesë e rëndësishme e së cilës ai cilëson edhe formimin e identitetit dhe personalitetit individual. Ndërsa foli për rolin e regjimit komunist, i cili shtypi të drejtat fetare, ai solli në kujtesë edhe problematikën e të drejtave të pronësisë me të cilat përballen bashkësitë fetare në Kosovë – një çështje që sipas tij ka mbetur e pazgjidhur pavarësisht tranzicionit të vendit në demokraci. Kjo sipas tij, bashkë me ligje problematike sfidojnë zhvillimin e qëndrueshëm të bashkësive fetare në vend. Në vijim, ai shtoi se pavarësisht vështirësive financiare me të cilat përballët Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), ky institucioni ka një bashkëpunim të pasur me bashkësi fetare dhe shoqërinë civile nga rajoni, organizatat ndërkombëtare dhe qeverinë e Kosovës. Sipas z. Sahiti, kjo është arritur në sajë të

synimit të BIK-ut për të kontribuar në ndërtimin e paqes.

At Photius, Abot i Manastirit të Berovos, pjesë e Kishës Ortodokse në Maqedoninë e Veriut foli për fenë dhe demokracinë në vendin e tij. Më tej ai u ndal te përpjekjet e udhëheqësve fetarë në rajon për të gjetur rolin e përshtatshëm në shoqëritë demokratike ku jetojnë. Ai nënvizoi se arritja e harmonisë mes besimeve të ndryshme është detyrë për të gjithë udhëheqësit fetarë, pavarësisht përkatësisë së tyre. Sipas tij, për një kohë të gjatë, në Maqedoninë e Veriut, bashkësitë fetare s’kanë mundur të ndërtojnë ura bashkëpunimi me shtetin apo me njëra-tjetrën. Megjithatë, At Photius vuri në pah që kjo ka ndryshuar me kalimin e kohës. Si rrjedhojë, ato sot kanë vendosur marrëdhënie dhe kanë ndërtuar ura komunikimi mes tyre. Mirëpo, kjo ka ardhur disi me vonesë pasi bashkësitë fetare tani përballen me sfida të reja të lidhura me perceptimin negativ që ka ndërlidhja e fesë me politikën. Prandaj, udhëheqësit fetarë duhet të udhëheqin me shembuj të mirë dhe të kontribuojnë më shumë në shoqëri. Sipas tij, udhëheqësit fetarë dhe bashkësitë përkatëse duhet të punojnë më shumë me të rinjtë dhe t’i orientojnë ata drejt ideve dhe vlerave të shëndetshme, përfshi edhe edukimin e shëndetshëm të tyre mbi rolin e bashkësive fetare në demokraci. Ai e mbylli fjalimin duke shtuar se gjetjet e anketimit të elitës, në të cilën bëhej thirrje për një rol më aktiv të udhëheqësve fetarë në promovimin e vlerave dhe parimeve universale, bashkë me nevojën për të shërbyer me vepra të mira në komunitet, duhet të shërbejnë si nxitje për atë dhe udhëheqësit e tjerë fetarë.

Sesioni vijoi me prezantimin e studimit të z.

Marko Veković, Ndihmës Profesor për Fenë dhe Politikën pranë Universitetit të Beogradit, mbi marrëdhëniet shtet-fe në Serbi dhe Malin e Zi. Z. Veković theksoi se shkencat politike rrallëherë trajtojnë rolin e fesë në politikë, pasojë e së

cilës janë edhe botimet e pakta në këtë fushë. Për t'iu përgjigjur pyetjes nëse bashkësitë fetare parandalojnë apo pasurojnë demokracinë, ai u ndal te shpjegimi i llojit të marrëdhënieve mes shtetit dhe fesë në Serbi dhe Malin e Zi. Në studimin e tij, ai shqyrton zhvillimin e të ashtuquajturës 'toleranca e ndërsjellë' në të dy vendet e analizuara. Koncepti i 'tolerancës së ndërsjellë' sugjeron që marrëdhëniet shtet-fe në shoqëritë demokratike duhet të bazohen në autonomi dypalëshe ku shteti nuk ndërhyr në punët e fesë dhe anasjelltas. Por sipas z. Marković, kjo nuk ndodh as në Malin e Zi dhe as në Serbi, pasi të dyja këto shtete kanë marrëdhënie të ngushta me bashkësitë fetare dominuese, e cila i shërben interesave të ngushta politike. Nga ana tjetër, edhe bashkësitë fetare shpesh ndërhyjnë në çështje të politikës. Sipas autorit, të dyja këto dinamika nuk ndihmojnë në zhvillimin e demokracisë, gjë që e bën të nevojshme të formohen korniza ligjore dhe institucionale për të saktësuar funksionin përkatës të bashkësive fetare.

Drejtori i Kërkimit në Institutin GAP në Kosovë, **z. Jeton Mehmeti**, vuri theksin te nevoja për një kornizë ligjore brenda së cilës të kryejnë funksionet e tyre bashkësitë fetare. Sipas tij, ky është minimumi që shteti duhet të bëjë. Megjithatë, sipas z. Mehmeti, autoritetet në Kosovë nuk ia kanë dalë të përmbushin këtë nevojë si pasojë e pengesave të shfaqura. Sfida kryesore lind nga nevoja për miratimin e një drafti ligjor me mbështetjen e minoriteteve. Duke patur parasysh rolin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, kjo nuk është bërë e mundur që projektligji i hartuar para nëntë viteve të miratohej në kuvend. Gjithsesi, kjo përbën shqetësim pasi ligji aktual mbi fetë ka shumë mangësi, pavarësisht se garanton lirinë e fesë. Ndër to është edhe mungesa e statusit ligjor për bashkësitë fetare.

Pjesëmarrësit filluan diskutimin pas prezantimit dhe trajtuan çështjen e marrëdhënieve shtet-fe si dhe nënvizuan ndjeshmërinë e saj pasi ajo duhet të sanksionohet nga shteti. Për më tepër, ata ranë dakord që këto dy pole të qëndrojnë të shkëputura nga njëra-tjetra, si e vetmja mënyrë që do të lejonte si shtetin edhe bashkësitë fetare

të përqendrohen në rolet e tyre përkatëse. Si zgjidhje për këtë, gjatë bisedimit u sugjerua krijimi i institucioneve që trajtojnë rolin e bashkësive fetare brenda shtetit. Sipas folësve, institucione të tilla do lejonin bashkësitë fetare të kontribuonin në proceset demokratike në vendet e tyre. Pjesëmarrës të tjerë theksuan që pavarësisht se feja mund të ndikojë në shoqëri pa një saktësim ligjor, bashkësitë fetare nuk mund ta bëjnë këtë në proceset demokratike nëse besimi nuk është institucionalisht i ndarë nga shteti. Biseda u pasua me vënien e theksit te nevoja që bashkësitë fetare të përshtatën me sfidat e kohës, veçanërisht me ato ideologjike pasi ato ndikojnë në formimin e ndërgjegjes dhe identitetit. Në përpjekje për të ndërtuar marrëdhënie me shtetin, bashkësitë fetare nuk duhet të lënë pas dore ndërtimin e një marrëdhënieje të shëndoshë me shoqërinë ku ushtrojnë funksionin e tyre duke promovuar vlera të rëndësishme universale.

Pjesë e diskutimeve ishte edhe projektligji i ri i propozuar në Malin e Zi, i cili synon të sanksionojë rolin e bashkësive fetare në vend, një pikë e rëndësishme e së cilës është edhe shtetëzimi i pronave të para 1911-ës, gjë që ka ngjallur shumë reagime. Disa pjesëmarrës në konferencë u shprehën se qëllimi kryesor i këtij ligji është krijimi i një bashkësie të re fetare për të zëvendësuar ato ekzistuese. Kjo, sipas tyre është theksuar në projektligj ku nënvizohet se qendra e bashkësive fetare që ushtrojnë funksionin e tyre në vend, duhet të jetë në Malin e Zi dhe jo në një vend tjetër. Për folësit, kjo nënkupton se qeveria e Malit të Zi nuk njih Kishën Ortodokse Serbe si përfaqësuese të besimtarëve në vend dhe në vend të saj njih Kishën Ortodokse Malazeze.

Një nga pjesëmarrësit ngriti dyshimet e veta nëse ky projektligj është në harmoni me standardet evropiane dhe vuri në pah shqetësimin e tij lidhur me faktin që është vetë qeveria ajo që e harton dhe zbaton këtë ligj. Për më tepër, ai theksoi që kjo nismë e qeverisë së Podgoricës ngre dyshime se po manipulohet feja me qëllim krijimin e një identiteti të ri kombëtar. Folës të tjerë vunë në pah që nisma të tilla ka edhe në vendet e tjera të rajonit duke nënvizuar që në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, qeveritë vendase përpiqen, ku më shumë e ku më pak, që të ndërhyjnë në

punët e fesë. Nisur nga kjo, folësit shtuan që besimi fetar shpesh manipulohet për përfitime politike. Si rezultat, as feja, dhe as shteti nuk janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra.

Pjesëmarrësit ranë dakord që është e nevojshme të bëhet dallim mes rregullave ligjore dhe ndërhyrjes, pasi e para nënkupton ndarjen e përgjegjësive dhe sanksionon funksionet dhe hapësirën vepruese të secilës. Ndërsa e dyta nënkupton mungesën e qartësisë dhe rregullave. Prapëseprapë, mbetet sfiduese shkëputja nga e kaluara komuniste dhe kapërcimi i vështirësive që hasen, gjë që e bën të vështirë rritjen e bashkëpunimit paralel me ndarjen e përgjegjësive përkatëse. Megjithëse ka variante të ndryshme bashkëpunimi mes shtetit dhe bashkësive fetare, alternativa më tërheqëse është ajo që bazohet në rregulla të qarta dhe të formuluar me ndjeshmëri ndaj shqetësimeve dhe nevojave të palëve të përfshira.

Societati 3

Feja, shteti dhe siguria

Sesioni 3: Feja, shteti dhe siguria

Sesioni i tretë nxiti pjesëmarrësit të diskutonin sfidat që paraqet bashkëjetesa ndërjetare në Ballkanin Perëndimor dhe pasojat që ka feja mbi bashkëpunimin rajonal. Të pranishmit u ndalën të ndikimet e huaja në besimet fetare dhe shtuan se kjo ka pasoja edhe për bashkëpunimin rajonal, përfshi edhe sektorin e sigurisë. Diskutimet lidhur me këtë temë u nxitën nga fjalimi i z. Mladen Mrdalj, Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Studimet Qeverisëse në Beograd, i cili foli për rëndësinë e angazhimit të udhëheqësve fetarë dhe bashkësive përkatëse dhe shpalosi disa nga mënyrat me anë të të cilave ata mund të kontribuojnë për nxitjen e bashkëpunimit dhe paqes në rajon. Z. Valon Dasharami, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve në Malin e Zi vuri në pah rolin historik të minoriteteve në vendin e tij dhe bëri një përmbledhje të marrëdhënies së tyre me shtetin. Fjalimin kryesor të këtij sesioni e mbajti Julianne Funk, hulumtuese pranë Fondacionit Helenik për Politikën e Jashtme dhe Evropiane, e cila prezantoi studimin e saj mbi nismat për nxitjen e paqes nga udhëheqësit fetarë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në fund, ajo përmendi një sërë mënyrash nëpërmjet të cilave feja mund të ndihmojë në nxitjen e bashkëjetesës paqësore mes bashkësive fetare.

z. Mladen Mrdalj, Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Studimet Qeverisëse në Beograd theksoi se bashkësitë fetare duhet të angazhohen më shumë në shoqëri. Sipas tij, është e domosdoshme që bashkësitë fetare të përshtatën me kohën, kërkesat dhe sfidat e tyre. Në vijim, ai shtoi se bashkësitë fetare duhet të gjejnë mënyrën e përshtatshme për të funksionuar në demokraci liberale si dhe të kontribuojnë në promovimin e vlerave të tyre. Liria e fjalës, theksoi ai, është testi më i mirë i tolerancës pasi dëshmon sesi e trajtojnë bashkësitë fetare debatin e hapur dhe kritikën. Në vijim, ai theksoi se është shumë e rëndësishme që bashkësitë fetare të dënojnë praktikën e kësaj në shoqëri si korrupsionin dhe degradimin mjedisor. Megjithatë, kjo nuk ka

ndodhur akoma, pasi sipas z. Mrdalj, bashkësitë fetare dhe udhëheqësit e tyre i shmangen debateve politike dhe politikës në përgjithësi. Në fund të fjalimit, ai u ndal te marrëdhëniet ndërjetare dhe ndëretnike në Ballkanin Perëndimor dhe shtoi se bashkësitë fetare duhet të bëjnë përpjekje për të zbutur dallimet mes tyre; për të promovuar bashkëpunimin ndërjetar dhe bashkëjetesën pavarësisht sfidave që shfaq retorika nacionaliste.

Rëndësia e sanksionimit të marrëdhënies shtet-fe dhe bashkësive fetare mbetet një pyetje e hapur dhe sfidë për shumë prej vendeve të rajonit, temë e cila u trajtua në pjesën tjetër të sesionit të dytë. **z. Valon Dasharami, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve në Malin e Zi** u përqendrua te projektligji i ri mbi bashkësitë fetare në vendin e tij. Sipas z. Dasharami, projektligji i është paraqitur Komisionit të Venecias, të cilit i është kërkuar një opinion i pavarur. Në vijim ai adresoi shqetësimet e ngritura nga projektligji për shtetëzimin e pronave të bashkësive fetare. Disa pjesëmarrës vunë në pah se përmbajtja e projektligjit të propozuar ka shqetësuar të gjitha bashkësitë fetare në Malin e Zi. Siç edhe u sqarua në sesionin e mëparshëm, ligji sugjeron që qendra e bashkësive fetare duhet të jetë në Malin e Zi. Për sa i përket Kishës Ortodokse ligji ngre dyshimi se ai është favorizues ndaj Kishës Ortodokse Malazeze. Kjo kërkesë bëhet edhe më problematike kur konsiderohet Kisha Katolike, qendra e së cilës është në Vatikan. Z. Dasharami pranoi se bashkësitë fetare kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre lidhur me projektligjin në fjalë, por ai shtoi se qeveria ka hapur dialogun me përfaqësuesit e tyre dhe po shqyrton mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje mbi çështjet e diskutuara. Në vijim, ai shtoi se qeveria e tij do të marrë në shqyrtim komentet e Komisionit të Venecias për të siguruar përfaqësimin e të gjitha grupeve të interesit dhe të drejtat përkatëse të bashkësive fetare, të cilat do të pasqyrohen në projektligj.

Julianne Funk, hulumtuese pranë Fondacionit Helenik për Politikën e Jashtme dhe Evropiane prezantoi studimin e saj për kampet e paqes të ndërtuara nga shoqëria civile në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe rolin e fesë në aktivitetet paqëndrues. Znj. Funk vijoi prezantimin e saj duke shpjeguar sesi aktivistët e shoqërisë civile punojnë dhe bashkëpunojnë me udhëheqësit fetarë vendorë për të luftuar stereotipat fetare dhe etnike të grupeve të ndryshme. Kjo sipas saj hedh themelet e bashkëjetesës paqësore mes tyre. Si shembull ajo solli në vëmendje Bashkësinë Islame në Bosnjë dhe Hercegovinë e cila ka qëndruar neutrale ndaj aktiviteteve paqëndruese të udhëhequra nga shoqëria civile për vite me radhë. Megjithatë, kohët e fundit, ajo ka bërë përpjekje të kufizuara për të ndaluar përfshirjen e elementeve fetare në këto nisma. Gjithsesi, mospërfshirja e tyre nuk e ka penguar punën e aktivistëve. Në vijim, ajo nënvizoi se mbështetja e bashkësisë fetare dhe ndihma e saj në procesin e ndërtimit të paqes do t'i jepte jetë të re kësaj nisme në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Edhe vetë Këshilli Ndërfetar i Bosnjë dhe Hercegovinës nuk i ka mbështetur këto aktivitete. Mundësia që kjo të ndryshojë në të ardhmën është shumë e vogël. Znj. Funk nënvizoi që mbështetja e Këshillit Ndërfetar ka qenë vetëm me fjalime simbolike, por asnjëherë me përfshirje në terren. Fjalimi i saj nxiti diskutime lidhur me mundësinë e bashkëpunimit mes bashkësive fetare dhe shoqërisë civile si një platformë për

shkëmbimin e përvojave dhe ideve. Në përgjigje, znj. Funk u shpreh se gjatë viteve 1990-të, në Bosnjë dhe Hercegovinë ka pasur tendencë për të mënjeluar bashkëpunimin me bashkësitë fetare, por kjo ka ndryshuar me kalimin e viteve. Megjithëse bashkëpunimi nuk është kufizuar në nivelin vendor, bashkëpunimi institucional mbetet i kufizuar. Lidhur me mundësinë e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe bashkësive fetare në të ardhmen, ajo shprehu besimin e saj se kjo mund të arrihet në nivelin vendor.

Në vijim të bisedës, z. Mrdalj ritheksoi nevojën për të rritur bashkëpunimin dhe shkëmbimet rinore mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo bëhet akoma më e rëndësishme për të ndihmuar procesin e pajtimit pasi shkëmbimet rinore u japin mundësi të rinjve të njihen me bashkëmoshatarët e tyre të një besimi dhe etnie tjetër. Kjo do të ndërtonte ura komunikimi dhe do të sfidonte stereotipat.

Sesioni u përmbyll me qëndrimin e audiencës se bashkëpunimi mes bashkësive fetare dhe shoqërisë civile është i një rëndësie parësore për përpjekjet e ndërtimit të paqes dhe bashkëjetesën paqësore në rajon. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se është me rëndësi të angazhohen grupet e interesit në proceset legislative që synojnë të sanksionojnë të drejtat dhe funksionet e bashkësive fetare si mënyra më e mirë për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e tyre.

Socialisti

Islami dhe laiciteti në Ballkanin Perëndimor

4

Sesioni 4: Islami dhe laiciteti në Ballkanin Perëndimor

Në sesionin e fundit të konferencës, Muhamed ef. Hadžić, Kryemyftiu i Beogradit dhe z. Mariglen Demiri nga Instituti i Shkencave Sociale dhe Humane në Shkup, të cilët kontribuuan me një fjalim hapës të pasuar me fjalimin kryesor të mbajtur nga znj. Zora Hesová, e cila njohu pjesëmarrësit me traditat islamike në Bosnjë dhe Hercegovinë. Diskutimet filluan pas një përshkrimi përmbledhës mbi pozicionin e islamit në shoqëritë e rajonit dhe rolin e tij në kundërvënien e radikalizimit dhe ekstremizmit me ndikim nga jashtë vendit. Në vijim, pjesëmarrësit diskutuan mundësinë e modelit të islamit të praktikuar në rajon si diçka që mund të pasohet në shoqëritë e tjera evropiane, gjithnjë duke marrë shkas nga traditat islamike në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Muhamed ef. Hadžić, Kryemyftiu i Beogradit foli mbi rëndësinë e dialogut ndërfaqetor në shoqëritë moderne dhe rolin e fesë në shoqëritë laike dhe demokratike. Ndërsa procesi i laicitetit ngriti pyetje lidhur me ndikimin e fesë në shoqëri, politikë dhe fusha të tjera me rëndësi, kjo nuk i bën ato faktorë të parëndësishëm në shoqëri. Sipas kryemyftiut, roli i fesë në sferën publike është kyç, ne nuk duhet të harrojmë që për arsye politike feja vazhdon të instrumentalizohet. Kjo, sipas z. Hadžić e bën të nevojshme qasjen e përbashkët të bashkësive fetare për bashkëjetesë paqësore dhe respekt të ndërsjellë. Në vazhdim ai hodhi dyshime mbi ndarjen e ngurtë të fesë nga shteti si mënyra më e mirë për funksionimin dhe bashkëpunimin e institucioneve fetare me ato shtetërore kur këto të fundit veprojnë në mënyrë të pavarur, plotësisht të ndara nga njëra-tjetra. Ai vazhdoi fjalimin e tij duke shtuar se është shumë e vështirë të thuhet saktësisht sesi duhen përcaktuar marrëdhëniet mes tyre, ndërsa shtoi që me rëndësi thelbësore është garantimi dhe mbrojtja e lirive fetare për të gjithë qytetarët, pa dallim përkatësie.

Muhamed ef. Hadžić ngriti një çështje me rëndësi gjatë fjalimit të tij, duke shtuar se ka një tendencë për të raportuar më shumë në media për sulme terroriste dhe lidhjet e grupeve terroriste sesa për sulme ndaj xhamive në perëndim. Diçka e tillë është pasqyruar edhe në anketime ku dallohet tendenca e medias për të raportuar rastet negative të marrëdhënive ndërfaqetare, por duke anashkaluar plotësisht ato pozitivet. Të anketuarit në Malin e Zi e cilësuan këtë tendencë si kërcënim të bashkëjetesës fetare. Kjo ka një ndikim të keq në perceptimin e përgjithshëm të harmonisë fetare pasi qytetarët nuk informohen për shembujt e bashkëjetesës, kjo për shkakun se mediat nuk i cilësojnë ato si 'lajme të vlefshme'.

Mariglen Demiri nga Instituti për Shkenca Sociale dhe Humane në Shkup u pajtua me bashkëfolësit se besimi mund të luajë një rol të rëndësishëm në sferën publike, por shtoi se feja nuk duhet të politizohet ose të përdoret si monopol nga politikanët. Në vazhdim, ai bëri një përmbledhje të çështjeve aktuale me të cilat përballët islami në Maqedoninë e Veriut, ku interes të veçantë përbën ndikimi nga jashtë. Sipas z. Demiri, në Maqedoninë e Veriut bashkëjetojnë dy forma islami, ai tradicional dhe ai që cilësohet si 'i ri'. Të dyja kanë ndikimin e tyre të veçantë në shoqërinë e vendit të tij. Islami tradicional ka një historik të gjatë në vend, por si rrjedhojë e kushteve të dobëta socio-ekonomike ai është i sfiduar. Myslimanët që jetojnë në kushte të tilla, në përpjekje e sipër për të 'dalë' nga rrethanat rënduese si varfëria, mungesa e qartësisë mbi qëllimin e jetës apo çështje të tjera të lidhura me cilësinë e jetës dhe përfaqësimin, kërkojnë 'shpëtimin' në rrugë të ndryshme. Disa prej tyre përqafojnë edhe besimin fetar me përkushtim dhe kërkojnë qartësi në tekstet e shenjta. Meqë format tradicionale të interpretimit të besimit nuk kanë arritur të japin një shpjegim të kënaqshëm,

ata e kërkojnë këtë qartësi në interpretime të tjera fetare. Disa prej tyre janë aq të ndryshme sa mund të cilësohen edhe si forma radikale nga mësuesit fetarë tradicionalë dhe si të tilla mund të nxisin individë të veçantë të radikalizohen. Në krahasim nga kjo formë, islami tradicional është më afër njerëzve të zakonshëm dhe si i tillë mund të shfrytëzohet nga politikanët për të mobilizuar popullin. Megjithëse Maqedonia e Veriut përballet me sfidën e fenomenit të luftëtarëve të huaj dhe të rikthyerve nga luftimet jashtë vendit, qeveria në vend ka treguar pak interes për të ofruar zgjidhje, apo për të ndihmuar të kthyerit për t'u integruar në shoqëri.

Znj. Zora Hesová, Hulmutuese pranë Qendrës Kërkimore AMO dhe Ndihmës Profesore pranë

Charles University, prezantoi studimin e saj mbi traditën e islamit në Bosnjë dhe Hercegovinë si një shembull i islamit 'liberal' në Evropë të titulluar "Tradita Islame: Pikëpyetjet e Modelit Boshnjak". Sipas saj, Bosnja shpesh shihet si shembulli i një shtetit laik me shumicë myslimane i cili ngre pyetje të shumta për mënyrën e bashkëjetesës së një besimi fetar me ligjet dhe rregullat e veta përkrah një shteti laik dhe demokratik. Së fundmi, ajo ngriti pyetjen se çfarë mund të mësojnë vendet e tjera evropiane nga ky shembull. Përfundimet e nxjerra nga studimi i znj. Hesová pasqyrojnë trajektoren e zhvillimit të islamit në Bosnje si pasojë e institucioneve të përqendruara, reformimit intelektual dhe modernizimit bashkë me vetë-rregullimin dhe vetë-financimin. Si rrjedhojë, ajo doli në përfundimin se islami boshnjak është më shumë sesa një model fetar pasi përfaqëson një traditë fetare të zhvilluar për dekada në kushte të veçanta dhe si i tillë nuk mund të transferohet diku tjetër.

Gjatë diskutimit mes folësve dhe pjesëmarrësve, u trajtua islami boshnjak dhe arsytet përse ai nuk mund të shërbejë si model për vendet e tjera, veçanërisht në Evropën Perëndimore. Sipas znj. Hesová, islami në Bosnjë është zhvilluar gjatë një periudhe të gjatë historike, gjatë të cilit ka ndryshuar dhe është përshtatur me kohën. Me kalimin e kohës ai u kthye në një organizatë, sistem të sanksionuar dhe intelektual. Sipas saj, po të përqendrohemi tek këto tipare, atëherë islami boshnjak mund të shërbejë si shembull për vendet e tjera pasi i kushton rëndësi të theksuar institucionalizimit të fesë dhe bashkësive fetare – diçka që është e pamundur të krijohet në shoqëritë liberale në perëndim.

Si përfundim, të pranishmit ranë dakord që islami dhe bashkësia islame në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, luajnë një rol të rëndësishëm në historinë e marrëdhënieve ndërfaqetare në rajon. Megjithatë, mbetet sfiduese konceptimi i islamit boshnjak si model që mund të adaptohet nga vende të tjera pasi islami siç e njohim ne, është produkt i një historie të gjatë, plot me përshtatje të nxitura nga rrethanat dhe të mbështetura në zhvillimin e mendimit intelektual. Në vijim u vu re që një zhvillim i tillë pasqyron aftësinë e vendit për t'ia dalë edhe nga rrethanat më të vështira, përfshi këtu edhe luftën civile dhe mungesën e tolerancës fetare. Një ndër sfidat me të cilat përballet vendi sot janë luftëtarët e huaj të rikthyer nga Siria dhe Iraku. Pjesëmarrësit theksuan nevojën e shtetit për të investuar në riintegrimin e tyre në shoqëri. Bashkësitë fetare, veçanërisht ato islame, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces.

erfüllndi
p^üerfülln
erfüllnd
un^üdi
im^üet
un^üdi

Përfundimet

Konferenca mblodhi një grup të larmishëm interesi të interesuar për rolin e fesë në Ballkanin Perëndimor të cilët përcollën kureshtjen e tyre me pjesëmarrje në diskutime të frytshme mbi ndikimin e fesë në aspekte të ndryshme të shoqërisë. Pjesëmarrësit patën mundësi të dëgjonin dhe ndanin me të tjerët këndvështrimet e tyre mbi rolin e fesë në shoqëri nga pikëpamja e bashkësive fetare, qeverisë, shoqërisë civile, medias dhe akademikëve.

Feja ka një ndikim të moderuar në pjesën e madhe të shoqërive në rajon, megjithatë, udhëheqësit fetarë duhet të marrin mbi supe një rol më aktiv në shoqëri nga ku edhe mund të japin kontributin e tyre në sfera të ndryshme të shoqërisë bashkëkohore. Nisur nga kjo, udhëheqësit fetarë ranë dakord që institucionet ndërfetare kanë mundësi të ndërtojnë mbi dialogun ndërfetar dhe të kontribuojnë për bashkëjetesën. Gjithsesi, kjo mbetet e paarrirë në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në mënyrë që bashkësitë fetare të kryejnë sa më mirë funksionet e tyre, është e domosdoshme që qeveritë përkatëse të hartojnë ligje që përcaktojnë me qartësi rolin e tyre. Është gjithashtu me rëndësi që të sanksionohen me ligj përgjegjësitë që kanë bashkësitë fetare dhe qeveria për të garantuar

liritë fetare. Për të mënjeluar keqpërdorimin e besimit fetar nga politika, është me rëndësi të ndahen besimi dhe shteti si dhe të përcaktohet me ligj roli i tyre ndaj njëri-tjetrit, si mënyra më e mirë për të parandaluar ndërhyrjen e shtetit apo elementëve politikë në çështjet e fesë. Bisedimet nxorën në pah mundësitë e pashfrytëzuara të besimeve fetare për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe nxitjen e paqes, veçanërisht nëse nismave të tilla iu bashkërenditen shoqëria civile dhe të rinjtë. Pjesëmarrësit arritën në përfundimin se bashkësitë fetare dhe shteti duhet të marrin përsipër një rol më të rëndësishëm për të parandaluar ndikimet e jashtme si dhe të ndihmojnë me riintegrimin e të kthyerve nga Siria, Iraku apo konflikte të tjera.

Së fundmi, folësit dhe pjesëmarrësit e konferencës u pajtuan me të anketuarit, përgjigjet e të cilëve u përmbledhën në raportin e anketimit se bashkësitë fetare dhe udhëheqësit e tyre mund të luajnë një rol të rëndësishëm në shoqëritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Duke patur parasysh rolin e tyre, udhëheqësit fetarë kanë një mundësi të artë për të ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndërfetare dhe për të promovuar dialogun ndërfetar për të gjithë brezat, veçanërisht të rinjtë. Në ndërtimin e dialogut mes bashkësive fetare, me qeverinë, shoqërinë civile, akademikët dhe të rinjtë, është e domosdoshme që të nxirren mësimet dhe të përfitohet nga konferenca si kjo.

